



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:207635

Datë: 23.11.2020

Numri i dokumentit: 01290222

P. nr.1006/2019

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse-praktikanten Antigona Zahiti, në lëndën penale ndaj të pandehurit: N.A., për shkak të dy veprave penale: Vjedhje nga neni 325 par.1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5067/2018, të datës 19.09.2019, të rikualifikuar nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar në veprë penale: Vjedhje në vazhdim nga neni 325 par. 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 12.11.2020 në prezencën e prokurorit të shtetit Natasa Radovic dhe të pandehurit, me datë 16.11.2020 publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.11.2020 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

N.A., nga i ati L., e ëma Sh., e vajzërisë A., “data e lindjes”..., në fshatin..., komuna e Mitrovicës, tani me vendbanim në Mitrovicë, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me nr. personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

**I**

Me datë 31.07.2018, rreth orës 15:40, në Mitrovicë, ka përvetësuar pronën e personit tjetër me qëllim që vetit t'i sjell përfitime pasurore, në atë mënyrë që nga vetura kombi, e pa mbyllur me çelës, e cila ka qenë e parkuar në afërsi të rrethit, ka marrë një tablet “IPD” të tipit “Nextbook” ngjyrë të zezë, në vlerë prej rreth 100 euro, pronë e të dëmtuarit J.Z..

**II**

Me datë 14.09.2018, në periudhën kohore prej 16:00-17:00, në Mitrovicë, ka përvetësuar pronën e personit tjetër me qëllim që vetes t'i sjell përfitime pasurore, në atë mënyrë që nga vetura, e pa mbyllur me çelës, e cila ka qenë e parkuar në afërsi të bankës N..., ka marr një telefon celular ngjyrë hiri, të tipit “S...” në vlerë prej rreth 200 euro, pronë e të dëmtuarit I.B..

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhje në vazhdim nga neni 325 par.1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 73, 81, 325 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, të akuzuarit i:

## SHQIPTON

1. Me dënim me burg në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
2. Me dënim me gjobë në shumën prej 600 € (gjashtëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në kohëzgjatje prej 3 muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në tre këste të barabarta, më së largu deri me datën 05 të muajit vijues. Nëse i akuzuari nuk e paguanë gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtuqë dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Obligohen i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimare të gjykatës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Të dëmtuarit, J.Z.dhe I.B., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridik civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.5067/2018 të datës 19.09.2019, kundër të pandehurit N.A., nga Mitrovica, për shkak të dy veprave penale: Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë prokurori i shtetit e ka rikualifikuar këto dy vepra penale në vepër penale: Vjedhje në vazhdim nga neni 325 par. 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së. Tutje gjatë shqyrtimit fillestar i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet më barrë, ndihem shumë keq që ka ndodhur kjo, e di që kam gabuar, ndihem thellësisht i penduar dhe i premtoj gjykatës që nuk do ta përsëris më këtë vepër, andaj e lus Gjykatën që ti merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se, janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjendet në shkresat e lënës, prandaj i propozoj Gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese me ratsin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti i oficerit, datë 31.07.2018 dhe 14.09.2018; Deklarata e të dëmtuarit J.Z., dhënë në polici, datë 31.07.2018; Deklarata e të dëmtuarit I.B., dhënë në polici, datë 14.09.2018; Deklarata e të pandehurit N.A., dhënë në polici, datë me dt. 18.09.2018; Vërtetimi për sekuestrimin e sendeve, datë 18.09.2018; Vërtetimi mbi sendet e kthyer, i datës 22.09.2018; Vërtetimi për sekuestrimin e sendeve, datë 18.09.2018; Vërtetimi mbi sendet e kthyer, i datës 18.09.2018. Të gjitha këto prova janë

bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Vjedhje në vazhdim nga neni 313 par.1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat më të cilat është kryer vepra, e po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethanë rënduese edhe përseritjen e veprës penale. Kjo për faktin se nga shkresa e Gjykatës Themelore në Mitrovicë nr. 3806/2020, datë 16.11.2020 rezulton se i njëjti është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë edhe në disa raste. Ndërsa vetëm për veprën penale: Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, është dënuar në këto raste: Aktgjykimin P.nr.206/2018, i plotëfuqishëm nga data 11.12.2018; Aktgjykimin P.nr.212/2018, i plotëfuqishëm nga data 15.04.2019; Aktgjykimin P.nr.626/2018, i plotëfuqishëm nga data 21.03.2018; Aktgjykimin P.nr.778/2018, i plotëfuqishëm nga data 03.04.2019; Aktgjykimin P.nr.1042/2018, i plotëfuqishëm nga data 13.11.2019; Aktgjykimin P.nr.133/2015, i plotëfuqishëm nga data 01.06.2017.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, rrethanat personale ngase sipas deklaratimit të tij i njëjti është martuar, dhe mbajtës i familjes, si dhe faktin se palëve të dëmtuara në rastin konkret i janë kthyer sendet, çka konstatohet në bazë të vërtetimeve përkatëse.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg dhe me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga cenimi i pasurisë së njerëzve dhe nga çfarëdo veprimi që bie ndesh me ligjin.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me paushallin gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensim viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.1006/2019, dt.23.11.2020**  
**2019:207635, 23.11.2020**

Procesmbajtësja:  
Antigona Zahiti

**Gjyqtari**

---

**Rrahman BEQIRI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.